



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:136516

Datë: 17.01.2024

Numri i dokumentit: 05202253

P.nr.1796/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarës U.S.nga F. K., e akuzuar për veprën penale Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2565/21 të datë 29.06.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 10.01.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu dhe të akuzuarës U. S., me datë 12.01.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 17.01.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara U. S., e bija e A. dhe nëna R. e gjinisë B., e lindur me, në M. KK O., me vendbanim në fshatin P. KK F. K. Rr. “J. G.” nr... me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer fakultetin ekonomik, e martuar, nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Sepse:

Me datë 27.05.2021 rreth orës 17:30min në Fshatin S... në maketin “V. F.” në F. K. e pandehura me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme për veti apo për personin tjetër në mënyrë të kundërligjshme e përvetëson pasurinë që i është besuar asaj kështu që gjatë punës si arkëtare në marketin “V. F.” në arkën nr.1 i ka skanuar artikujt e konsumatorëve e pastaj e ka përdor kartelën Zero duke bërë fshirjen e produkteve të skanuara dhe kështu ka përvetësuar 100 Euro me ç ‘rast të dëmtuarës – menaxheres A. H. i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 100 Euro.

- *Me këtë e ka kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 318, paragrafi 1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44 69, 70, 71, 72 dhe 318 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarën:

E G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve i cili dënim me pëlqimin e të pandehurës zëvendësohet në dënim me gjobë në shumen prej 300.00 (treqind) Euro, dhe
- II. Me **DËNIM ME GJOBË** në shumen prej 200.00 (dyqind) Euro. Obligohet e pandehura që dënimin me gjobë në shumen e përgjithshme prej 500.00 (pesëqind) Euro ta paguaj në afat prej 60 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse e pandehura dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- IV. Obligohet e pandehura që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- V. Pala e dëmtuar A. H. nga F. K. udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në procedurë të rregullt civile juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.2565/21 të datë 29.06.2021, ndaj të akuzuarës U.S.për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 318, paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.01.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu dhe të akuzuarës U.S. ku e njëjta u njoftuan me të drejtat e saj, me aktakuzën dhe provat kundër saj. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurës.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori e pandehura u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurës dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se e pandehura ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, e pandehura është e vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarës se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurës U.S .qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 318, paragrafi 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se e akuzuara e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarës, kështu që e njëjta është penalisht përgjegjëse.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarën, gjykata ka vlerësuar faktin se e njëjta ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier e përgjegjshme për veprimet e saj dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer e po ashtu edhe faktin se e njëjta nuk kishte qenë ndonjëherë e dënuar për ndonjë vepër penale. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarës. Rrethana rënduese nuk janë konstatuar nga ana e Gjykatës.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 43 të KPRK-se të akuzuarën e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarës është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurës ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjta të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1796/21 datë 17.01.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtut. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.